



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 15. 01. 2019

VENDIM
Nr. 4, datë 15. 01. 2019

PËR
TARIFAT E CIKLIT TE DYTE TE STUDIMEVE

Mbështetur në neni 3, pika 3, shkronja c, d, në nenin 47, 49 pika 1, gërma a, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë" i ndryshuar, në mbledhjen e datës 15.01.2019, Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë listën me 49 (dyzetë e nëntë) studentë që ndjekin ciklin e dytë të studimeve, bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi, përfitues nga reduktimi në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2018-2019, si dhe efektet financiare të parashikuara nga ulja apo reduktimi, në zbatim të pikës 1 gërma "f" dhe "g", të Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Të miratojë efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për përjashtimin apo reduktimin në masën 50 % të tarifës vetore të shkollimit për 49 (dyzetë e nëntë) studentëve, bashkëlidhur lista pjesë e këtij vendimi, me kosto financiare 2,982,000 mijë lekë.
3. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohen Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ornela Koleka- Anëtar

Florian Nurce- Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Eduard Ahmeti- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar